



Prishtinë, 18 korrik 2012  
Kodi i ZRRE-së: V\_431\_2012

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 33 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,

në seancën e mbajtur me datë 18 korrik 2012 nxori këtë:

## VENDIM

- I. MODIFIKOHET Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (me kushte)** e dhënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.)–Divizioni i Shpërndarjes–me numër licence ZRRE/Li\_06/06, e cila ka qenë e vlefshme nga data 04.10.2006 deri 04.10.2036.
- II.** Licenca e modifikuar (tani e tutje “Licencë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes”) me numër ZRRE/Li\_06/12 do të hyjë në fuqi në datën e nxjerrjes së këtij vendimi dhe do të jetë e vlefshme deri me **04 Tetor 2036**. Obligohet Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A) që të zbatojë të gjitha dispozitat e licencës së modifikuar.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në dhjetor të vitit 2011 ka filluar procedurën për modifikim të licencës për shpërndarje të energjisë elektrike të Korporatës Energjetike të Kosovës, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 04.10.2006. Modifikimi ka filluar në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjeve në sektor të energjisë.
- Me 27 janar 2012 ZRRE ka publikuar në ueb faqen e saj draft – licencën e sipërpërmendur për komente nga palët e interesuara. ZRRE ka marrë parasysh edhe komentet e palëve të interesuara dhe përfundimisht ka harmonizuar dispozitat e kësaj licence me legjislacionin primar dhe sekondar në sektor të energjisë.
- Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*\*Bashkëngjitur licenca e modifikuar.*

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar